



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2648 Dt 01.11.2022

Senati i Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2022, mori:

VENDIM

- I. Anulohet pjesërisht konkursi për angazhimin e stafit akademik në procesin mësimor për vitin akademik 2022/2023, sipas konkursit të datës 14.09.2022
- II. Anulimi i konkursit të shpallur më 14.09.2022, do të bëhet për këto pozita:
Fakulteti i Gjeoshkencave
 1. Një asistent për Grup lëndësh në fushën Vendburimet minerale;
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore;
 1. Një mësimdhënës për lëndën: Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore;
 2. Një asistent për lëndët: Bazat e informatikës; Softueri aplikativ në inxhinierinë mjedisore dhe Softueri aplikativ në inxhinierinë ushqimore;
 3. Një asistent për lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I; Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; Teknologjia e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura; Trajtimi i ujërave të zeza II dhe Materiet ndotëse në produktet ushqimore;**Fakulteti i Edukimit**
 1. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e edukimit muzikor; Bazat e mësimin muzikor dhe Interpretim me instrumente;
 2. Një asistent për lëndët: TIK në arsimin fillor.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitat nga pika II bëhet për arsye se:

Në **Fakultetin e Gjeoshkencave**, për pozitën “Një asistent për Grup lëndësh në fushën Vendburimet minerale”, asnjë kandidat nuk i plotëson kriteret e konkursit.


Në **Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore**, për pozitën “Një mësimdhënës për lëndën: Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore” dhe për pozitën “Një asistent për lëndët Bazat e informatikës; Softueri aplikativ në inxhinierinë mjedisore dhe Softueri aplikativ në inxhinierinë ushqimore”, nuk ka aplikuar asnjë kandidat. Ndërsa, për pozitën “Një asistent për lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I; Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; Teknologjia e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura; Trajtimi i ujërave të zeza II dhe Materiet ndotëse në produktet ushqimore”, raporti i komisionit recensues nuk është i saktë në të dhënat e paraqitura për kandidatët që kanë aplikuar, si dhe janë bërë shkelje procedurale të Rregullores nr.1670 dt. 28.09.2021, e cila nuk parasheh që kandidatët të hynë në test (provim) me shkrim.

Në **Fakultetin e Edukimit**, për pozitën “Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e edukimit muzikor; Bazat e mësimin muzikor dhe Interpretim me instrumente”, dhe për pozitën “Një asistent për lëndët: TIK në arsimin fillor”, asnjë kandidat nuk i plotëson kriteret e konkursit.

Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrës për informim me publikun


Prof. dr. Alush Musaj
Kryesues i Senatit
